

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I FILOLOGJISË



MA EDONA JAHU

**SHTRESËZIMET SHOQËRORE DHE
GJEOGRAFIKE TË ZANOREVE TË
NGRITJES SË MESME DHE TË ULËT NË
VERNAKULARIN E PRISHTINËS**

PUNIM I DOKTORATËS

Mentori:
Prof.Ass.Dr.Shpëtim Elezi

Prishtinë, 2024

UNIVERSITY OF PRISHTINA
FACULTY OF PHILOLOGY

MA EDONA JAHIU

**SOCIAL AND GEOGRAPHICAL
STRATIFICATION OF LOW AND MIDDLE
VOWELS IN THE VERNACULAR OF
PRISHTINA**

DOCTORAL THESIS

Mentor:
Prof.Ass.Dr.Shpëtim Elezi

Prishtina, 2024

REZYME

Ky punim trajton distribucionin e varianteve fonetike të zanoreve të ngritjes së ulët dhe të mesme në dimension social dhe gjeografik në vernakularin e Prishtinës me respondentë të të gjitha moshave, niveleve arsimore, ekonomike e përkatësive gjinore – e folmja e të cilëve i përket gegërishtes verilindore, por me diferenca fonetike të dallueshme brenda qyteteve e grupeve të caktuara.

Dallimet fonetike brenda dy kryedialekteve të shqipes, toskërishtes e gegërishtes, janë të theksuara sidomos në shkallën e hundorësisë, gjatësisë së zanoreve, që përbëjnë karakteristikë të dialektit gegë, por edhe në vetitë kualitative të tyre. P.sh. në Kosovë (dhe në viset e tjera gege) ë-së së theksuar të toskërishtes i përgjigjet fonema /a/ me alofonet e saj, por ndonjëherë përfshihen edhe alofonet e saj të labializuara dhe variantet e fjalës *nënë* mund të jenë: [nã:n nɔ:n nän] etj., që varësisht se cili zgjidhet, dëgjuesi/ja, përpos kuptimit të konceptit, merr edhe informata sociale e gjeografike. Pastaj, diftongjet e vjetra [ae oe], në shumë të folme kanë dhënë një fonemë të gjatë [tɪ θa:/a], [tɪ θe:/ɛ:], e togjet *ua, ue* – u të gjatë: *mësue* [msu:m]. Kësisoj, situata gjuhësore në Kosovë duhet të kuptohet dhe të shpjegohet si *continuum* varietetesh e kodesh që përdoren në situata e domene të ndryshme, sipas shtresëzimeve shoqërore: moshës, gjinisë, statusit social, arsimimit. E njëjta vlen edhe për kompleksitetin e shfaqjes së alofoneve, si realizime të ndryshme të së njëjtës fonemë, të cilat paraqiten divergjente në qytetet e Kosovës, veçanërisht te zanoret *a, e, o*.

Studimi, pas incizimit të intervistave me 156 respondentë të grupmoshave 13-65 vjeç, ka analizuar shtrirjen sociale, por edhe atë të qytetit të caktuar prej nga vijnë banorët prishtinas të alofoneve të zanoreve të ngritjes së mesme dhe të ulët, ndryshimin edhe brendafolës në stilin vernakular. Janë marrë parasysh situata socio-ekonomike e respondentëve, mosha, gjinia, arsimimi, vendi ku janë rritur për të konstatuar se këto fonema janë treguese të kategorizimit shoqëror të banorëve prishtinas. Ato nuk ndikojnë në realizimin e kuptueshmërisë së dyanshme, por mund të prodhojnë paragjykime për prejardhjen apo statusin social e përkatësinë shoqërore. Në bazë të frekuencës përdorimore të këtyre zanoreve e alofoneve të tyre, janë vërtetuar ndryshoret si: gjinia, niveli i arsimimit dhe mosha, të cilat e kanë tipik një nyjtim dhe se cilat u afrohen më tepër nyjëtimeve standarde, që edhe pse s'janë përcaktuar si normë drejtshqiptimore, mbështetur në bazën dialektore toske, u “ikin” hundorësisë e gjatësisë, megjithëse nuk mund t'i shmangin tërësisht. Ka dëshmuar se vajzat e gratë ndërfitin edhe specifika të zanoreve toske (mbizotëruese

të standardit) si dhe shqiptime inovative, si përpjekje për ta përfshirë varietetin me prestigj, megjithëse të moshat e shtyra dalin në sipërfaqe veçorinë fonetike native, si tipare më dominuese. Po ashtu, moshat e reja ‘thyejnë’ zakonshmërinë nyjëtimore të shumë fjalëve, krahas atyre sociolektale, dhe priren drejt eksperimentimit fonetik. Gjendja ekonomike dhe arsimimi po ashtu ushtrojnë presion (in)direkt në (mos)përmbajtjen ndaj normave standarde, e shqiptimit më të kujdesshëm. Qytetet si Drenasi, Ferizaj, Rahoveci e Podujeva paraqiten si më konservatore në ruajtjen e varianteve fonetike treguese të cilat e definojnë prejardhjen vetëm nga shkalla e dendurisë së shfaqjes së varianteve zanore të dallueshme.

Hulumtimi është zhvilluar në Prishtinë, që si kryeqytet, është shndërruar në një hapësirë përfaqësuese të të folmeve nga pothuajse të gjitha qytetet e Kosovës, banorët e të cilave vijnë për arsye shkollimi, punësimi apo vizite. Punimi ka dëshmuar lidhje të ngushtë mes karakteristikave të ndryshoreve sociale dhe ndryshimeve nyjëtimore të këtyre zanoreve dhe alofoneve të tyre.

Fjalët kyçe: zanoret e ulëta, zanoret e mesme, alofonet, faktorët sociolinguistikë, vernakulari i Prishtinës, shqiptime inovative

SUMMARY

This study examines the distribution of phonetic variants of the low and middle vowels in the social and geographic dimensions of the Prishtina's vernacular, with respondents of all ages, educational backgrounds, places, and gender affiliations. Their speech is classified as Gheg dialect, although there are significant phonetic differences within specific cities and groups.

Both the degree of nasality and the length of vowels, which are characteristic to the Gheg dialect, as well as their qualitative characteristics, highlight the phonetic distinctions between the two main Albanian dialects, Tosk and Gheg. For example, in Kosova (and in other Gheg places), the stressed /ë/ of the Tosk dialect corresponds to the phoneme /a/ and its allophones, but sometimes some labialized allophones: [nã:n nɔ:n nän] etc. Depending on which one is chosen, the listener, in addition to understanding the concept, also receives social and geographical information.

The old diphthongs [ae oe], in many dialects have given a long phoneme [tɪ θa:/a], [tɪ θe:/ɛ:] (you said), and the vowel groups ua, ue have given /u/: [msu:m] (we learned). Thus, the linguistic situation in Kosovo should be understood and explained as a continuum of varieties and codes that are used in different situations and domains, according to social stratification: age, gender, social status, and education. The same applies to the complexity of allophones, as different realizations of the same phoneme appear divergent in the cities of Kosovo, especially for the vowels a, e, and o.

This study, after recording interviews with 156 respondents of the age group 13–65 years, has analyzed the social scope, but also that of the specific city where Prishtina residents come from, the allophones of middle and low vowels, and the intra-speaker variation in vernacular style. The socio-economic state of the respondents, age, gender, education, and the place where they grew up were taken into account to determine that these phonemes and their variants are indicators of the social categorization of Prishtina residents. They do not affect the realization of mutual understanding, but they can produce prejudices about origin, and social affiliation. Based on the frequency of use of these vowels and their allophones, variables such as: gender, education level, and age have been proven to be typical of an articulation and closer to standard articulations, which, although there are not any defined orthographic norms, but based on the Tosk dialectal base, they “escape” nasality and length, although they cannot completely avoid them.

It has been proven that girls and women also incorporate specific vowels (predominant in the standard) as well as innovative pronunciations as an attempt to include the prestigious variety, although at advanced ages, the native phonetic features are more dominant. Also, youngsters 'break' the familiarity of many words, in addition to sociolectal ones, and tend towards phonetic experimentation.

The economic situation and education also exert (in)direct pressure on (dis)compliance with the standard norms of more careful pronunciation. Cities such as Drenas, Ferizaj, and Podujeva are presented as more conservative in preserving indicative phonetic variants, which define the origin only by the degree of density of the occurrence of distinct sound variants. Additionally, there is (in)direct pressure from the educational system and the economy to adhere to the usual norms of more cautious pronunciation. It is demonstrated that certain cities, like Drenas, Ferizaj, and Podujeva, are more cautious in maintaining suggestive phonetic variants, which identify the origin solely by the frequency of various sound variants.

The research was conducted in Prishtina, which, as the capital city of Kosova, has been transformed into a representative space of speech from almost all the cities of Kosova, whose residents come for education, employment, or visit. The paper has proved that there exists a significant link between the characteristics of social variables and the changes of these vowels and their allophones.

Key words: low vowels, middle vowels, allophones, sociolinguistic factors, Prishtina's vernacular, innovative pronunciations